



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 03.04.2023

Nr: 42

Ora: 11:30

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 41, DATË 31.03.2023, PARAQITUR NGA SUBJEKTI  
ZGJEDHOR “ALEANCA E MAQEDONASVE PËR INTEGRIM EUROPIAN”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.04.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Subjekti zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian”  
përfaqësuar nga Kryetari z. Vasil Sterjovski

**OBJEKT:** Kërkesë për regjistrimin e listës shumëemërore të kandidatëve për  
anëtar të Këshillit Bashkiak në bashkinë Pustec, qarku Korçë, nga partia  
“Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian”.

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21, pika 1, germa "c", 133-136 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

**Rrethanat e çështjes:**

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 për "Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, subjekti "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" ka kërkuar të depozitojë në KZAZ nr. 71 të Bashkisë Pustec, listën shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak të kësaj bashkie, bashkë me dokumentacionin përkatës.
3. Në datën 27.03.2023 KZAZ nr. 71 e bashkisë Pustec ka filluar shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak të Partisë "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" dhe duke e konstatuar atë me mangësi, ka refuzuar të marrë në dorëzim me arsyetimin se ky dokumentacion ishte i paplotë.
4. Partia "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" ka paraqitur kërkesën ankimore ku pretendon se:
  - Dokumentacioni i dorëzuar nga ana e partisë është i rregullt, me përjashtim të një Letërnjoftimi ID, të cilin e dispononin me foto;
  - Megjithëse nga ana e KQZ është rekonaduar pranimi i dokumentave, vetëm njëri nga anëtarët e KZAZ nr. 71 nuk pranon të firmosë procesverbalin për marrjen në dorëzim të tyre;
  - Partia "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" mbron interesat e komunitetit maqedonas në Shqipëri, dhe për shkak të faktit se sipas tyre Bashkia Pustec është bashki

minoritare e banuar nga komunitet maqedonas, mospranimi i dokumentacionit nga ana e anëtarëve të KZAZ ka qëllime politike dhe i sjell dëme komunitetit maqedonas.

5. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 03.04.2023, ora 11:30.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 41, datë 31.03.2023;
- Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve në KZAZ nr. 71 Pustec.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Referuar parashikimeve të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, listat e kandidatëve për këshillat vendorë së bashku me dokumentet e kandidimit depozitohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore përkatëse. Neni 73 i Kodit Zgjedhor përcakton se KZAZ, pasi merr në dorëzim dokumentacionin përkatës, verifikon rregullsinë e tij dhe nëse vëren parregullsi apo mospërbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Dokumentacioni i korrigjuar më pas depozitohet brenda 3 ditësh në KZAZ. Më pas KZAZ duhet të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar brenda 48 orësh nga depozitimi i tyre.
2. Nga hetimi administrativ i zhvilluar në KAS rezultoi se përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian” ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të dorëzuar në KZAZ të dokumentacionin e nevojshëm për rregjistrimin e listës së kandidatëve për këshillin vendor brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
3. Rezultoi i provuar fakti se brenda këtij afati, KZAZ ka bërë aty për aty një vlerësim paraprak të dokumentacionit të kandidimit dhe më pas, duke vërejtur se kishte mangësi, ka ndërprerë këtë proces duke refuzuar pranimin e dokumentacionit me aresyetimin që ka ardhur me vonese.
4. KAS vlerëson se në rastin konkret, në momentin e dorëzimit në KZAZ të dokumentacionit të kandidimit nga subjekti zgjedhor Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian” brenda

afatit ligjor, pavarësisht mangësive eventuale në të, veprimtaria e KZAZ në zbatim të pikës 1 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor konsiderohet se ka filluar, për rrjedhojë ajo duhet të vazhdojë dhe nuk mund të ndërpritej. Në këtë kontekst dokumentacioni i subjektit zgjedhor Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrim European” konsiderohet I pranuar nga KZAZ.

5. KAS vëren se në zbatim të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, KZAZ nr. 71, pasi të verifikonte rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vërente parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, duhet t’ia kthente atë subjektit zgjedhor për korrigjim duke e vënë në dijeni me detyrimin që dokumentacioni i korrigjuar duhet të depozitohet jo më vonë se afati i parashikuar në pikën 2 të nenit 73 të Kodit. Vetëm pas këtij procesi, KZAZ mund të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar. Kjo procedurë qartësisht rezultoi se nuk është zbatuar në rastin konkret. Pranimi i dorëzimit të këtij dokumentacioni, qoftë edhe me mangësi, nuk është mundësuar pa ndonjë shkak të arësyeshem por thjesht duke pretenduar se ai kishte parregullsi. Kodi Zgjedhor nuk parashikon në asnjë rast mundësinë e KZAZ për të refuzuar menjëherë marrjen në dorëzim të dokumentacionit, edhe nëse pretendohen parregullsi.
6. Jo pa arsye, Kodi Zgjedhor e ka konceptuar procesin e dorëzimit të dokumentacionin për rregjistrimin e listës së kandidatëve për këshillin bashkiak si një proces ndërveprues dhe bashkëpunues ndërmjet vetë subjektit zgjedhor nga njëra anë dhe administratës zgjedhore (të përfaqësuar nga KZAZ në rastin konkret) nga ana tjetër. Mosrespektimi i procedurës në fjalë nga KZAZ, passjell cënimin e një interesi të ligjshëm jo vetëm të ankimuesit por edhe të publikut. Kjo në funksion të faktit se partitë politike dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhje me kandidatë, gëzojnë mbrojtje të vecantë ligjore, për vetë faktin se janë baza e pluralizmit politik në vend. Në nenin 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikohet se *“Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.”*. Në nenin 3 të po këtij ligji parashikohet se *“Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.”*. Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që përcakton parimet themelore të saj, parashikon se *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia*

*kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë". Neni 45 pika 1 i Kushtetutës parashikon se "Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet."*

7. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, ka theksuar se "...Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme" dhe "Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor".
8. Nga hetimi administrativ në KAS rezultoi se në momentin e shqyrtimit të këtij ankimi, subjekti zgjedhor Partia "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" i ka riparuar tashmë parregullsitë eventuale në dokumentacionin për regjistrimin e listës së kandidatëve, duke eliminuar në këtë mënyrë çdo pengesë për vijimin nga KZAZ të procesit të regjistrimit të listës së kandidatëve të kësaj partie për këshillin bashkiak të bashkisë Pustec.
9. Përsa më sipër, KAS konstaton se ankimi është i drejtë dhe tashmë është detyrë e KZAZ nr. 71 të shqyrtojë kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak në bashkinë Pustec, qarku Korçë, të partisë "Aleanca e Maqedonasve për Integrim European" në përputhje me parashikimet e nenit 73 të Kodit Zgjedhor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 21 dhe në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve,

## V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 41, datë 31.03.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrim European”.
2. Detyrimin e KZAZ nr. 71, Pustec, të pranojë dhe të shqyrtojë kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak në bashkinë Pustec, qarku Korçë, të partisë “Aleanca e Maqedonasve për Integrim European”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>